VENDIM
Nr.97, datë 11.2.2005

PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES TË PËRDORË PROCEDURËN "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË", PËR PRODHIMIN E MUNICIONEVE LUFTARAKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të nenit 3 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët", të ndryshuar dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes, që, për fondin e vet limit prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, miratuar në buxhetin e vitit 2005, zëri "Municion luftarak", të përdorë procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë", me kombinatin mekanik, Poliçan, për prodhimin e municioneve luftarake, sipas pasqyrës "A", që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fyqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PASQYRA "A"
DETAJIMI NË SASI DHE FONDI LIMIT I PRODHIMIN E MUNICIONEVE PËR VITIN 2005

Nr.	**Emërtimi**	**Sasia në copë**	**Fondi limit Në lekë**
1.	Prodhim fishek imitues 7,62 mm M-56	242439	3 904 000
2.	Shtimje imituese 85 mm mod 56 (përshëndetëse)	200	96 000
	Gjithsej		4 000 000